

DISA FAKTE TE RËNDËSISHME
RRETH INFEKSIONIT

**HIV
AIDS**



*Të jeni më të hapur në mendimet tuaja,
Të jeni më guxintarë në veprat tuaja,
Të arritni më shumë në hapin tuaj.*

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen
tonë në internet

www.aksionplus.net www.NCSO-al.org

Adresa: Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr 1;
Rr. Stavro Vinjau; Prapa ambasadës amerikane. Tiranë

Cel. 0692066359
e-mail: gencaxionp@albmail.com
Website: www.aksionplus.net
& NCSO-al.org



Aksion Plus 2014



DISA FAKTE TE RËNDËSISHME RRETH INFEKSIONIT HIV/AIDS

1. Ç'është HIV?

HIV është virusi që shkakton SIDA-n.

Ç'është SIDA?

SIDA është forma më e rëndë e infeksionit HIV, që duke dëmtuar sistemin imunitar e ekspozon atë ndaj infeksioneve të rënda me natyrë bakteriale, virale, parazitare, mykotike si dhe ndaj formave të kancerit. Momentalisht për HIV/AIDS nuk ka shërim.


2. Shfaqja e AIDS mund të zgjasë deri në dhjetë vjet nga koha e infektimit me virusin HIV. Për këtë arsye, njeriu i infektuar me HIV mund të duket dhe ndihet mirë me shëndet për shumë vjet, por ai ose ajo mund t'ia transmetojë virusin dikujt tjetër. Terapi të reja ilacesh mund ta ndihmojnë personin të qëndrojë mirë me shëndet për periudha më të gjata kohe, por ai/ ajo vazhdon të jetë i/e infektuar me HIV-in dhe është i/e aftë ta transmetojë atë.

3. Virusi HIV transmetohet me anën e:

- Spermës
 - Sekrecioneve vaginale
 - Gjaktut dhe produkteve të tij
 - Qumështit të nënës (HIV-i transmetohet përmes nënës së infektuar tek foshnja që lind. Nënata e infektuara, në një të tretën e rasteve, lindin fëmijë të infektuar. Shumica e foshnjave të infektuara vdesin brenda pak viteve.
-
- HIV-i transmetohet më shpesh me rrugë seksuale. Kjo për arsye se lëngjet përzihen dhe virusi mund të shkëmbehet, vecanërisht kur ka carje në mukozën vaginale ose anale, plagë, ose infeksione të tjera seksualisht të transmetueshme. Vajzat janë vecanërisht të prekshme nga infeksioni HIV, sepse mukoza vaginale është më e hollë dhe më e prekshme nga infeksioni se ajo e grave të rritura. Ekzistojnë të dhëna që tregojnë se rreziku për të transmetuar HIV nga meshkujt tek femrat është disa herë më i madh sesa nga femrat tek meshkujt. Transmetimi mund të ndodhë gjatë gjithë fazave të infeksionit/sëmundjes.
 - **Rreziku i transmetimit seksualisht të HIV/AIDS mund të ulet nëse njerëzit praktikojnë gjithmonë seks të sigurt duke përdorur prezervativë.**
 - HIV-i mund të transmetohet edhe kur lëkura pritet ose shpohet nga gjilpëra, shiringa, brisqe, thika ose mjete të tjera të pasterilizuara. Njerëzit që injektojnë drogë ose që kryejnë seks me përdorues drogë, kanë rrezik të lartë për t'u infektuar me HIV/AIDS. Për më tepër, përdorimi i drogës e dobëson gjykimin e njeriut dhe mund të çojë në sjellje seksuale të rrezikshme, si mospërdorimi i prezervativit.

4. Virusi HIV nuk transmetohet nga:

- Lotët, pështyma, djersa, urina apo feçet sepse sasia e HIV-it në to është e vogël për të shkaktuar infeksion, por po të bien në kontakt me gjakun e personit të infektuar, këto lëngje bëhen burim infeksioni.
 - Nga kafshët e ndryshme shtëpiake.
 - Nga mushkonja apo insekte të tjera.
 - Gjatë përqaimit apo dhënies së dorës, kolla apo teshtitja.
 - Gjatë ngrënies me persona të infektuar me HIV/ SIDA.
 - Në ambiente publike si banjo, dushe, pishina, telefon, vendet e punës, taksi, autobusë, fjetja në të njëjtët çarcafë, etj.
5. Diskriminimi i njerëzve të infektuar me HIV/AIDS ose cdokujt që mendohet të rrezikojë infektimin, shkel të drejtat individuale të njeriut dhe rrezikon shëndetin publik. Të infektuarve me HIV/AIDS duhet t'u tregohet kujdes dhe mbështetje.
6. Të gjithë ata që dyshojnë se mund të jenë të infektuar me HIV, duhet të kontaktojnë mjekun në mënyrë që t'u bëhet testimi dhe t'u ofrohet ndihmë në mënyrë konfidenciale. Në Tiranë ka tri qendra të analizave të gjakut për HIV: a) pranë Institutit të Shëndetit Publik, b) pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe c) Qendrës Kombëtare të Dhurimit të Gjakut pranë Spitalit Ushtarak. Përveç Tiranës, laboratorë diagnostikues ka në Shkodër dhe Vlorë, ndërsa analiza e shpejtë e gjakut ofrohet në të 26 rrethet e vendit. Testet konfirmuese mund të kryhen tek Instituti i Shëndetit Publik apo Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë.

A large, faint red ribbon symbol is centered in the background of the page.

EPIDEMIA HIV/SIDA DHE RREZIQET QE LIDHEN ME DROGAT

1. Virusi HIV mund të përhapet me shpejtësi midis injektuesve të drogës. Sapo përhapet më tej në këtë popullatë, HIV-i gjen rrugën në transmetimin heteroseksual dhe prenatal. Shumë shtete kanë përjetuar një përhapje të shpejtë të HIV-it midis përdoruesve dhe jashtë tyre, duke prekur zona shumë të shtrira të shoqërisë.

Shumë nga përdoruesit e drogave vijnë nga familje me të ardhura të ulëta. Kur infeksioni me HIV shkon drejt fazës së sëmundjes, kjo çon në rënje drastike të të ardhurave, gjë që rëndon më shumë gjendjen ekonomike dhe sociale.

Banka Botërore rekomandon që vendet me shkallë të ulët të epidemisë së HIV-it, duhet të veprojnë sa më shpejt për të zbatuar programe parandalimi, duke parë me prioritet grupet më të prekura nga infeksioni i HIV-it, sidomos përdoruesit e drogave me injektim (PDI).

1 DHJETORI ESHTE DITA BOTERORE E LUFTES KUNDER SIDA

SITUATA NE BOTE

- Në botë më shumë se 35 milionë njerëz jetojnë me HIV/SIDA.
- 3.3 milionë nga këta janë nën moshën 15 vjeç.
- Në 2012 rreth **2.3 milionë** njerëz janë infektuar nga HIV.
- 260.000 ishin nën 15 vjeç.
- Çdo ditë përafërsisht 6.300 persona infektohen nga HIV – pothuajse 262 persona çdo një orë.
- Në 2012 **1.6 milionë** njerëz vdiqën nga SIDA.
- 210.000 nga këta njerëz ishin nën 15 vjeç.
- Që prej fillimit të epidemisë më shumë se 75 milionë njerëz janë infektuar nga HIV-i dhe rreth 36 milionë kanë vdekur nga arsye relative me HIV-in.

Situata në Shqipëri

- Aktualisht në Shqipëri ka **680** persona që jetojnë me HIV/SIDA. Midis tyre janë dhe **33** fëmijë.
- Në **2013** janë raportuar **96 raste të reja**.
- Grupmosha më e prekur është 25-45 vjeç dhe mënyra kryesore e transmetimit është kontakti seksual.
- Gjithsej janë raportuar 118 vdekje nga HIV/SIDA.
- Terapia me ARV ofrohet **falas** në spitalin infektiv (QSUT).

- ✓ Epidemia e HIV/SIDA po rritet çdo ditë më shumë— të gjitha vendet e botës janë të prekura.
- ✓ Diagnoza e hershme ndihmon për të përmirësuar shendetin, si dhe për të parandaluar infektimin nga HIV.
- ✓ Injoranca ndaj HIV/SIDA do ta përhapë më shumë sëmundjen, prandaj duhet vepruar tani, pa humbur kohë.

SIDA vret, por injoranca vret me shumë

- Nga HIV infektohen të gjithë pa përjashtim; pa dallim kombësie, feje, moshe seksi, profesioni apo gjendje sociale.
- Pergjegjesite tona janë të përbashkëta në luftën kundër SIDA.

MERR NË DORË FATIN TËND

- Jep shembullin tend duke frymëzuar dhe të tjerët në fushatën kundër HIV/SIDA.
- Miku me HIV, mbetet prap miku im.
- Nëse mendon se je prekur nga HIV, vizitohu sa më shpejt te një doktor.
- Prezervativi është i vetmi mjet mbrojtës kundër infeksioneve seksualisht të transmetueshme dhe nga HIV/SIDA.
- Tani për tani infeksioni HIV/SIDA është i pashërueshëm sepse nuk ka trajtim efikas dhe një vaksinë.
- Parandalimi është e vetmja mënyrë që të mbron.
- Mos e bëj dashurinë dhe seksin burg prej të cilit mund të mos dalësh dot më.
- Përballë SIDA: Shëndeti juaj varet nga ju vetë.

- Personat që jetojnë me HIV/SIDA nuk duhet të diskriminohen – ata gezojnë të drejta njerezore si gjithë të tjerët. Personat me HIV/SIDA duhet të jenë pjesë e zgjidhjes së problemit.

2. HEPATITI OSE VERDHEZA

Zakonisht Hepatiti shkaktohet nga një virus që sulmon mëlçinë. Në fakt ka disa lloje: Hepatiti B dhe C ka shumë të ngjarë që të prekin përdoruesit e drogës dhe të çojnë në sëmundje serioze. Hepatiti B dhe C transmetohen nga një person tek tjetri njelloj si HIV (virusi i SIDA s):

- **Duke shkëmbyer veglat e çpimit.**
- **Duke bërë seks vaginal apo anal pa preservativ.**
- **Një grua shtatzënë që është e infektuar me Hepatit mund t'ja japë edhe fëmijës së saj.**

Hepatiti C (HCV) është më prevalent se HIV-i midis PDI-ve. Studime të ndryshme sugjerojnë se shanset e infektimit nga HCV nga një age e infektuar janë 2-3%, krahasuar me rreth 0.3% nga HIV-i.

Infeksioni nga hepatiti kronik dhe akut B (HBV) është një rrezik i mirënjohur nga përdoruesit e drogave me injektim (PDI). Ky virus mund të transmetohet horizontalisht midis partnerëve seksualë, apo vertikalisht nga nëna te fëmija. Trajtimi për HBV është i kushtueshëm dhe ka efekte vetëm në pak raste. Hepatiti C (HCV) mbizotëron në shumë popullata të PDI-ve.

HCV transmetohet duke përdorur të njëjtën shiringë, por dhe rrugë të tjera të tërthorta e bartin rrezikun e infeksionit. Rreth 20% të këtyre infeksioneve të PDI-të

çojnë në cirozë brenda 10-20 viteve. Nuk ka vaksinë për HCV, dhe ky infeksion është një nga më të përhapurit në popullatën e PDI-ve.

Impakti social i HCV është më pak dramatik se ai i HIV, por prania e sëmundjeve të tjera që lidhen me HCV-në, tregon për pasoja serioze ekonomike në ato vende ku ka numër të lartë të PDI-ve.

CILAT JANË EFEKTET?

Ti mund të mos kesh shenja. Në një gjendje akute (të acaruar) ti mund të ndihesh i sëmurë dhe i lodhur, ose nuk ke oreks, apo ndjen dhimbje në muskuj dhe kyçe. Lëkura dhe sytë marrin një ngjyrë të verdhë si limon.

Këto shenja mund të zgjasin nga 2 – 12 javë. Shumë njerëz shërohen nga Hepatiti B plotësisht. Ata që nuk shërohen do të kenë dëmtime serioze në mëlçi.

HEPATITI C ËSHTË MË I RREZIKSHËM.

Një herë po e more ai mund të bëhet kronik. Kjo do të thotë cirozë ose kancer në mëlçi disa vjet më vonë. Injektimi i drogës apo pirja e alkoolit e favorizon më shumë këtë që thamë më lart, dhe ti mund të prekesh nga forma të tjera të Hepatitit. Ka raste që persona kanë vdekur nga një atak i papritur.

Kujdes! Ti mund të infektosh një tjetër edhe nëse nuk ke shenja të dukshme.

SI MUND TA DI SE JAM OSE JO I INFEKTUAR?

Mënyra më e lehtë për ta mësuar është të pyesësh një mjek, ose të bësh një analizë gjaku. Qendra jonë mund të të ndihmojë për këtë gjë.

ÇFARË DUHET TË BËJ NËSE JAM I INFEKTUAR?

Shëndeti yt mund të përmirësohet duke mos u çpuar në asnjë mënyrë. Nëse çpohesh, përdor shiringa dhe age sterile, si dhe paisjet e tjera të jenë të pastra. Nëse kryen marrëdhënje seksuale, përdor gjithomë prezervativ madje dhe me partnerin tënd të rregullt.

Kur je shtazënë duhet ti thuash mjekut ose mamisë që të marrë masa të tjera për të mbrojtur foshnjen nga Hepatiti kur të lindë. Mos pi alkool në kohën kur je sëmurë nga Hepatiti dhe tre muaj pasi të shërohesh. Kujdesu për shëndetin dhe shko shpesh tek doktori.

SI MUND TA SHMANG HEPATITIN?

Nëse injekton drogë – përdor shiringa sterile dhe mjete të pastra sa herë që çpohesh. Në marrëdhënjet seksuale, përdor gjithmonë prezervativ.

A KA VAKSINË PËR HEPATITIN?

Po ka vaksinë për Hepatitin B. Pyesni në Qendër dhe në Klinika Mjekësore. Por edhe kur je i vaksinuar duhet të bësh seksin më të sigurtë dhe të çpohesh po në mënyrë të pastër.

3. Mbidoza

Shkaku kryesor i vdekjeve midis PDI-ve, para se të shfaqej HIV-i, ishte mbidoza. Në grupet që injektojnë, ku HIV-i është i pranishëm, vdekjet nga SIDA janë më të shpeshta se vdekjet nga mbidoza. Sëmundshmëria e lidhur me mbidozat që nuk shkaktojnë vdekjen, përfshin dëmtimin e trurit dhe të organeve të tjera të trupit.

Marrja e kombinuar e depresantëve në kohën e mbidozës ka të ngjarë që të jetë një faktor ndihmues. Alkooli është mbase një nga drogat depresante që konsumohet në kohën kur ndodh një mbidozë. Në disa raste kemi dhe kombinime të heroinës dhe kokainës.

GJASHTË PIKA RRETH INFEKSIONEVE SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

1. Njerëzit me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme kanë më shumë rrezik për t'u infektuar me HIV/AIDS dhe për ta transmetuar infektionin e tyre tek të tjerët. Njerëzit me infeksione seksualisht të transmetueshme duhet të kërkojnë trajtim të menjëhershëm , të shmangin penetrimin, ose të praktikojnë seks të sigurt (seks pa penetrim ose seks duke përdorur prezervativë) si dhe natyrisht, të informojnë partnerët e tyre.
2. Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme janë infeksione që mund të transmetohen nga një person tek tjeri nëpërmjet kontaktit seksual. Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme prekin njëlloj si meshkujt edhe femrat. Shumë Infeksione Seksualisht të Transmetueshme nuk kanë shenja të dukshme, kështu që një person mund të jetë i infektuar dhe të mos e dijë që është i infektuar si psh: rasti i infeksionit nga klamidia, hepatit viral apo lythet gjenitale. Një nënë e infektuar që nuk mjekohet mund t'ia transmetojë infektionin fëmijës së saj gjatë barrës dhe lindjes, si në rastin e herpesit, sifilizit etj.
3. Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme mund të shkaktohen nga viruse – si psh: Hepatitis (verdhëza), HIV, Herpesi etj, nga bakteriet- si psh:

gonorreja(skollamento), klamidia, sifilizi etj, nga parazitët- si psh zgjebja apo morri i gjenitaleve.

4. Personat e infektuar me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme mund të paraqesin disa shenja kryesore si : rrjedhje jo normale nga vagina, rrjedhje sekresionesh nga penisi, kruarje, skuqje, carje, pucrra dhe dhimbje të organeve gjenitale: dhimbje dhe djegie gjatë urinimit, dhimbje gjatë seksit.
5. Përdorimi korrekt i prezervativit gjatë marrëdhënieve seksuale **bën të mundur mbrojtjen** nga shumica e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme, **përfshirë këtu edhe HIV-AIDS. Është e rëndësishme** që prezervativi të përdoret në mënyrë korrekte, duke ndjekur rregullat e mëposhtme:
 - Kontrolloni datën e skadencës. Ruajini prezervativat në një vend të freskët dhe të thatë.
 - Mos e përdor prezervativin nëse amballazhi është i dëmtuar.
 - Mos përdor lubrifikues me përbërje vajore.
 - Hapeni paketën me kujdes që të mos cani prezervativin.
 - Sigurohuni që të jetë i vendosur në drejtimin e duhur. Mos e cmbështillni prezervativin pa e vënë në organin mashkullor.
 - Shtypni majën e prezervativit për të hequr ajrin.
 - Duke mbajtur majën e prezervativit, cmbështilleni atë duke mbuluar të gjithë organin mashkullor.
 - Mbasi të keni mbaruar së kryeri marrëdhënien seksuale, hiqeni prezervativin me kujdes, para se të zbutet organi mashkullor.
 - Hidheni prezervativin në një vend të sigurtë.
 - Prezervativin përdore **vetëm një herë**.

Sa herë që një person vendos të kryejë marrëdhënie seksuale, duhet të diskutojë me partnerin ose partneren mbi përdorimin e prezervativit dhe seksin e sigurtë. Përdorimi i prezervativit është tregues i respektit që një person ka për veten e tij/saj si dhe njëkohësisht për partnerin ose partneren.

6. Shumica e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme mund të mjekohen plotësisht. Nëse mendoni se keni një Infeksion Seksualisht të Transmetueshëm, mos merrni mjekim vetë në farmaci, por drejtohuni për vizitë tek një mjek specialist (infeksionist, dermatolog, gjinekolog) ose tek mjeku i familjes. Është shumë e rëndësishme që mjekimi i personit të infektuar të shoqërohet me informimin dhe mjekimin e përshtatshëm të partnerit apo partnerëve seksualë.

Të rinjtë që emigrojnë duhet të kërkojnë ndihmë mjekësore për Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme dhe infeksionin HIV/AIDS në këto raste:

- Kur të rinjtë praktikojnë sjellje seksuale të rrezikshme marrëdhënie seksuale të pambrojtura (pa prezervativ) me partner të rastësishëm, duke përfshirë edhe punonjës të seksit.
- Nëse mendoni se partneri/ja juaj i/e rregullt ka praktikuar ose praktikon sjellje të rrezikshme seksuale: marrëdhënie seksuale të pambrojtura (pa prezervativ) me partner të rastësishëm, duke përfshirë edhe punonjës të seksit.
- Nëse ju ose partner/ja juaj seksual/e injekton drogë dhe shkëmben shiringat dhe pajisjet e injektimit.
- Nëse ju ose partneri/ja juaj paraqesin ndonjë ose disa nga shenjat e sëmundjeve të përmendura më lart.

**Qendrat në të cilat bëhet testimi i gjakut për HIV/AIDS
dhe testime për Infeksionet Seksualisht
të Transmetueshme.**

1. Tropojë	Banka e Gjakut
2. Pukë	Banka e Gjakut
3. Burrel	Banka e Gjakut
4. Durrës	Banka e Gjakut
5. Krujë	Banka e Gjakut
6. Elbasan	Banka e Gjakut
7. Librazhd	Banka e Gjakut
8. Pogradec	Banka e Gjakut
9. Ersekë	Banka e Gjakut
10. Tepelenë	Banka e Gjakut
11. Gjirokastrë	Banka e Gjakut
12. Sarandë	Banka e Gjakut
13. Fier	Banka e Gjakut
14. Lushnje	Banka e Gjakut
15. Berat	Banka e Gjakut
16. Gramsh	Banka e Gjakut
17. Vlorë	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik
18. Korçë	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik
19. Peshkopi	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik
20. Shkodër	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik
21. Bulqizë	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik
22. Lezhë	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik
23. Kukës	Laboratori Mikrobiologjik i Shëndetit Publik

HIV AIDS



Shënim:

Në Tiranë ofrohen të gjithë llojet e testimeve për HIV/AIDS dhe Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme, si dhe bëhet konfirmimi i testeve të kryera në rrethe në:

- Institutin e Shëndetit Publik
- Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Laboratori i Mikrobiologjisë dhe Shërbimi i Sëmundjeve Infektive
- Qendrën Kombëtare të Dhurimit të Gjakut, pranë Spitalit Ushtarak

Në laboratorët në Vlorë dhe Shkodër ofrohet testi i shpejtë dhe Elisa për HIV. Në laboratorët e rretheve të tjera ofrohet vetëm testi i shpejtë për HIV, i cili duhet të konfirmohet në Qendrat e sipërpërmendura në Tiranë.